



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I STATISTIKAVE DHE ANALIZAVE

UDHËZUES
PËR HARTIMIN E ANALIZAVE TEMATIKE

Qershor 2026

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr.Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

Faqe 1 nga 8

Përmbajtja:

Akronime	3
Hyrje	4
I. QËLLIMI	5
II. PËRKUFIZIMI I ANALIZËS TEMATIKE.....	5
III. LLOJET E ANALIZAVE TEMATIKE	6
IV. PLANIFIKIMI I ANALIZAVE TEMATIKE	6
V. REZULTATET E PRITSHME	6
VI. PROCESI I HARTIMIT TË ANALIZËS TEMATIKE	7
VI.1. Identifikimi i temës	7
VI.2. Metodologjia	7
VI.3. Analiza dhe interpretimi	7
VI.4. Hartimi i raportit	7
VI.5. Konsultimi	8
VI.6. Përgjegjësia	8
VI.7. Miratimi	8
VI.8. Publikimi dhe shpërndarja	8
VI.9. Feedback	8
VII. HYRJA NË FUQI DHE RISHIKIMI.....	8

Akronime

- ASCAL – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
- ENQA – Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- ESG – Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë
- IAL – Institucion i Arsimit të Lartë
- QA – Quality Assurance / Sigurimi i Cilësisë
- TA – Thematic Analysis / Analizë tematike

Hyrje

Në dekadat e fundit, sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është zhvilluar nga një proces i fokusuar kryesisht në vlerësimin dhe akreditimin formal të institucioneve dhe programeve të studimit, drejt një qasjeje më analitike, reflektuese dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të arsimit të lartë. Në këtë kontekst, analizat tematike kanë marrë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm si instrument për identifikimin e prirjeve, sfidave, praktikave të mira dhe nevojave për zhvillim në nivel institucional dhe kombëtar (Braun & Clarke, 2006; Braun & Clarke, 2012).

Analizat tematike përbëjnë një nga mekanizmat më të rëndësishëm përmes të cilëve agjencitë e sigurimit të cilësisë mund të transformojnë informacionin e mbledhur gjatë proceseve të vlerësimit të jashtëm në njohuri të dobishme për politikëbërjen, zhvillimin institucional dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Përtej funksionit të tyre informues, ato kontribuojnë në forcimin e transparencës, rritjen e besueshmërisë së proceseve të akreditimit dhe promovimin e kulturës së cilësisë në arsimin e lartë.

Rëndësia e analizave tematike është theksuar qartë edhe në kuadrin evropian të sigurimit të cilësisë. *Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG 2015)*, në standardin 3.4 “*Thematic Analysis*”, përcaktojnë se agjencitë e sigurimit të cilësisë duhet të publikojnë periodikisht raporte që përshkruajnë dhe analizojnë gjetjet e përgjithshme të aktiviteteve të tyre të sigurimit të jashtëm të cilësisë. ESG thekson se, gjatë proceseve të vlerësimit, agjencitë grumbullojnë një sasi të konsiderueshme informacioni mbi institucionet dhe programet e studimit, i cili mund të përdoret përtej një procedure të vetme vlerësimi dhe të shërbejë si bazë për analiza të strukturuar në nivel sistemi. Këto analiza kontribuojnë në reflektimin dhe përmirësimin e politikave dhe proceseve të sigurimit të cilësisë në kontekst institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Po ashtu, publikimet e European Association for Quality Assurance in Higher Education (ENQA) kanë evidentuar rëndësinë në rritje të analizave tematike si pjesë integrale e veprimtarisë së agjencive të sigurimit të cilësisë. Në raportin “*ESG 2015–2018 ENQA Agency Reports: Thematic Analysis*”, ENQA vëren se analizat tematike nuk kufizohen më vetëm në përmbledhjen e rekomandimeve nga raportet e akreditimit, por përfshijnë gjithashtu analiza krahasuese, studime mbi tema specifike, anketa me palët e interesit, analiza të ndikimit të proceseve të sigurimit të cilësisë dhe projekte të përbashkëta kërkimore.

Sipas ENQA, analizat tematike ndihmojnë agjencitë të kuptojnë më mirë zhvillimet sistemike në arsimin e lartë, të identifikojnë tendencat afatgjata dhe të mbështesin institucionet e arsimit të lartë në adresimin e sfidave të përbashkëta. Gjithashtu, ato shërbejnë si instrument për rritjen e ndikimit të proceseve të sigurimit të cilësisë përtej vendimmarrjes së akreditimit, duke e orientuar sigurimin e cilësisë drejt përmirësimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit strategjik të sektorit të arsimit të lartë.

Në këtë kuadër, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë synon të institucionalizojë procesin e hartimit të analizave tematike si një instrument të rëndësishëm për:

- monitorimin e zhvillimeve në sistemin e arsimit të lartë;
- evidentimin e praktikave të mira dhe sfidave të përbashkëta;
- vlerësimin e ndikimit të proceseve të akreditimit;
- forcimin e mekanizmave të sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë;
- mbështetjen e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.

Hartimi i analizave tematike merr një rëndësi të veçantë edhe në kontekstin shqiptar, ku proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit kanë gjeneruar një bazë të gjerë të dhënash dhe evidencash mbi funksionimin, zhvillimin dhe sfidat e institucioneve të arsimit të lartë. Analizimi sistematik i këtyre të dhënave mundëson identifikimin e tendencave sektoriale, problematikave strukturore dhe fushave prioritare për përmirësim. Ky udhëzues synon të krijojë një qasje të standardizuar dhe të qëndrueshme për planifikimin, realizimin dhe publikimin e analizave tematike nga ASCAL, në përputhje me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë, praktikave të mira ndërkombëtare dhe nevojat e sistemit shqiptar të arsimit të lartë.

I. QËLLIMI

Ky udhëzues përcakton qëllimin, metodologjinë, procedurat dhe mekanizmat institucionalë për hartimin e analizave tematike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në funksion të zhvillimit të kulturës së cilësisë, përmirësimit të proceseve të sigurimit të cilësisë dhe mbështetjes së politikëbërjes në arsimin e lartë. Përmes analizimit sistematik të të dhënave dhe gjetjeve, analizat tematike kontribuojnë në identifikimin e zhvillimeve, praktikave të mira, sfidave dhe çështjeve me interes për sistemin e arsimit të lartë, duke shërbyer si instrument për reflektim institucional dhe përmirësim të vazhdueshëm.

II. PËRKUFIZIMI I ANALIZËS TEMATIKE

Analiza tematike është një proces sistematik identifikimi, interpretimi dhe analizimi të gjetjeve, prirjeve dhe modeleve të përbashkëta që dalin nga proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Analiza tematike nuk kufizohet vetëm në përmbledhjen e gjetjeve të raporteve të akreditimit, por synon interpretimin e tyre në nivel sistemi, për të identifikuar zhvillime strukturore, tendenca cilësore dhe nevoja për përmirësime.

Në kuadër të veprimtarisë së ASCAL, analizat tematike bazohen kryesisht në:

- raportet e vlerësimit të jashtëm institucional dhe të programeve të studimit;
- vendimet e akreditimit;

- proceset e monitorimit dhe follow-up;
- të dhënat statistikore të sistemit të arsimit të lartë;
- pyetësorët dhe konsultimet me palët e interesit;
- studime, anketa dhe burime të tjera plotësuese.

III. LLOJET E ANALIZAVE TEMATIKE

ASCAL mund të realizojë disa kategori analizash tematike:

- **Analiza sistematike të raporteve të sigurimit të cilësisë:** analiza të bazuara në raportet e akreditimit institucional, raportet e programeve të studimit, raportet e monitorimit; rekomandimet dhe gjetjet e ekspertëve;
- **Analiza tematike mbi çështje specifike:** analiza të cilat mund të fokusohen në tema të caktuara, si: ndërkombëtarizimi, kërkimi shkencor, mësimdhënia dhe të nxënit, digjitalizimi, siguri i brendshëm i cilësisë, punësimi, mobiliteti akademik, përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë, etj.;
- **Analiza mbi ndikimin e proceseve të akreditimit:** analiza të cilat synojnë të vlerësojnë ndikimin e rekomandimeve të akreditimit, përmirësimet e realizuara nga IAL-të, efektivitetin e proceseve të folloë-up dhe monitorimit, ndikimin e sigurimit të cilësisë në zhvillimin institucional, etj.;
- **Analiza me mbledhje shtesë të të dhënave:** ASCAL mund të realizojë anketa, intervista, fokus-grupe, analiza krahasuese ndërkombëtare, studime tematike në bashkëpunim me institucione partnere, etj.

IV. PLANIFIKIMI I ANALIZAVE TEMATIKE

ASCAL harton një plan vjetor për analizat tematike, në funksion të planifikimit dhe koordinimit të veprimtarisë analitike të institucionit.

Plani vjetor mund të rishikohet dhe përditësohet në rast të evidentimit të çështjeve emergjente ose prioriteteve të reja në sistemin e arsimit të lartë.

V. REZULTATET E PRITSHME

Përmes analizave tematike ASCAL synon:

- forcimin e kulturës së cilësisë;
- rritjen e ndikimit të sigurimit të cilësisë;
- përmirësimin e proceseve të akreditimit;
- identifikimin e zhvillimeve prioritare në sistem;
- mbështetjen e politikëbërjes.

Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr.Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë

Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail:info@ascal.al

Faqe 6 nga 8

VI. PROCESI I HARTIMIT TË ANALIZËS TEMATIKE

VI.1. Identifikimi i temës

Përzgjedhja e temës bëhet duke marrë në konsideratë:

- prioritetet strategjike të ASCAL;
- problematikat e evidentuara në raportet e akreditimit;
- opinionet e palëve të interesit;
- zhvillimet në arsimin e lartë;
- nevojat e institucioneve qeveritare.

Përzgjedhja e temës duhet të jetë në përputhje gjithashtu edhe me planin vjetor të ASCAL për analizat tematike dhe dokumentat e tjera të brendshme operationale.

VI.2. Metodologjia

Metodologjia mund të përfshijë:

- analizë përmbajtësore të raporteve;
- analizë statistikore;
- analizë krahasuese;
- metoda cilësore;
- metoda të kombinuara.

Raporti duhet të shpjegojë qartë burimet e të dhënave, periudhën e analizuar, kampionin, kufizimet metodologjike, etj.

VI.3. Analiza dhe interpretimi

Analiza duhet të:

- evidentojë prirjet kryesore;
- identifikojë problematikat strukturore;
- krahasojë praktikat institucionale;
- interpretojë ndikimin e gjetjeve në nivel sistemi.

VI.4. Hartimi i raportit

Raporti i analizës tematike mund të përmbajë, por pa u kufizuar në to:

1. Hyrjen;
2. Qëllimin;
3. Metodologjinë;
4. Analizën e gjetjeve;

5. Konkluzionet;
6. Rekomandimet;
7. Të dhëna statistikore, etj.

VI.5. Konsultimi

Projekt-raporti mund t'i prezantohet stafit dhe/ose përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë apo palëve të tjera të interesit, në varësi të llojit të analizës, me qëllim mbledhjen e komenteve mbi elementet që mund të mungojnë.

VI.6. Përgjegjësia

Hartimi, koordinimi dhe përpunimi i analizave tematike realizohet nga Sektori i Statistikave dhe Analizave, i cili është përgjegjës për mbledhjen, administrimin, analizimin dhe interpretimin e të dhënave të proceseve të sigurimit të cilësisë, si dhe për përgatitjen e analizave tematike në funksion të zhvillimit institucional dhe përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë. Sektori mund të bashkëpunojë, sipas rastit, me strukturat e tjera të ASCAL, ekspertë të jashtëm dhe institucione partnere për realizimin e analizave specifike.

VI.7. Miratimi

Analiza tematike miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i ASCAL në përputhje me procedurat e brendshme institucionale. Procesi i miratimit synon të garantojë njohjen institucionale mbi përmbajtjen e raportit, pa ndikuar në objektivitetin dhe rezultatet e analizës.

VI.8. Publikimi dhe shpërndarja

Raporti publikohet në faqen zyrtare të ASCAL dhe në varësi të temës së analizës, mund të prezantohet edhe në konferenca, seminare, tryeza konsultimi, aktivitete me IAL-të dhe partnerët institucionalë, etj.

VI.9. Feedback

Pas publikimit të analizës tematike, rekomandohet mbledhja e feedback-ut mbi kontributin dhe përmbajtjen e analizës tematike, me qëllim përmirësimin e analizave të ardhshme.

VII. HYRJA NË FUQI DHE RISHIKIMI

Ky udhëzues hyn në fuqi pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ASCAL dhe rishikohet periodikisht në përputhje me zhvillimet e kuadrit kombëtar dhe evropian të sigurimit të cilësisë.